



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.47/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), Dega në Ferizaj, paraqitur kundër Qazim Rrahmanit, kandidat për Kryetar Komune nga subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterëve në shtylla elektrike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës (PDAK), Dega në Ferizaj, ndërsa subjektit politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.09.2017, nga PDAK, me të cilën pretendon se Qazim Rrahmani kandidat për Kryetar Komune nga subjekti politik PAI, ka shkelur rregullat zgjedhore duke vendosur posterët në vend publik përkatësisht në shtyllat elektrike, po ashtu nga kjo mund të ketë ndonjë eksces nga rryma elektrike dhe të rrezikohet fshati.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur tri fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, të datës 24.09.2017, nuk ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se ne nuk kemi vendosur poster në hapësira publike për faktin se ende nuk i kemi përpunuar ata, dhe vendi ku parashtruesi i ankesës tregon ata poster nuk kanë qenë shtylla elektrike nga KEDS por kanë qenë në pronësi private. Megjithatë pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur katër fotografi nga vendi ku janë larguar posterat.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e bartësit të listës së PAI, janë vendosur në shtyllë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysht rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysht të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysht faktin se subjekti politik Partia e Ashkalinjëve për Integrim, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posterët në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 47/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylejmani

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.